

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me zyrtaren ligjore, Hikmete Veliu-Pajaziti, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. R nga Gj të cilin, me autorizim e mbronë av. Bh. D, për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188, par. 2, lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Komunale në Gjilan, PP. nr.718/2017, të datës 05.05.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 20.06.2017, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 23.06.2017, përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari B. R, nga babai H dhe nëna H, e lindur B, i lindur me datë ...në fsh. V, K. e jeton në Gjilan, në rr. “, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, taksist, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 28.04.2017, rreth orës 16.40 min, në rr. “...” në Gj, me dashje i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit H. I, në atë mënyrë që, meqë të dy janë punëtor të kompanisë “S”, pas një mosmarrëveshje rreth një udhëtari, është afruar tek vetura taxi “”, me nr. , të cilën e drejtonte vet i akuzuari dhe nga aty ka marrë një kablllo të rrymës, të gjatësisë cm dhe trashësisë 1.5 cm, mjet i rrezikshëm, i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, e ka goditur të dëmtuarin në kokë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, për shkak të të cilave ka kërkuar ndihmë mjekesore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan,

-me çka ka kryer veprën penale **Lëndimi lehtë trupori**, nga neni 188, par.2, lidhur me par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së, andaj, bazuar dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

## E G J Y K O N M E D Ë N I M M E K U S H T

Të akuzuarin B. R, me **Dënim me Kusht, Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1(një) viti e 6 (gjashtë) muaj, nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë

I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 (njëzet) €, e gjithë këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, ka paraqitur Aktakuzë P.II.nr.718/2017, të datës 05.05.2017, kundër të akuzuarit B. R, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188, par.2,lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Prokurorja e shtetit, Kujtesa Fazliu, në fjalën përfundimtare deklaroi se në shqyrtimin gjyqësor, pasi që i pandehuri B. pranoi fajsinë për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore, rezultoi se u vërtetua në tërësi gjendja faktike, ashtu siç është përshkruar në aktakuzën lëndore. I pandehuri fajsinë e pranoi në mënyrë vullnetare dhe vetëdije të plotë, pasi që nga ana e gjykatës u njoftua lidhur me pasojat dhe favorët e pranimit të fajsisë, andaj, mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve që e njëjta i përmban dhe kërkon nga gjykata që të pandehurin F, ta shpallë fajtor dhe t'ia shqiptojë sanksionin penal konform dispozitave ligjore. Gjykatës i propozon që para se të përcaktohet për llojin dhe lartësinë e dënimit, t'i vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. dhe pasi të analizohen të gjitha të lartë cekurat, propozon që të akuzuarit t'i shqiptohet sanksioni i merituar penal, në mënyrë që me shqiptimin e sanksionit të merituar penal të arrihet vet qëllimi i dënimit dhe njëherit, sanksioni penal të jetë si preventivë për të akuzuarin si dhe për personat në rrethin ku jeton i akuzuari që në të ardhmen mos të kryejë vepra të tjera penale e as të ngjashme.

Mbrojtësi i të akuzuarit, me autorizim, av. B. D, deklaroi se i propozon gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, t'i marrë parasysh rrethanat lehtësuese, si, pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarit, keqardhjen e shfaqur, sjelljen pas konfliktit, fakti se ai për herë të parë është ndeshur me ligjin, e pastaj, t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë, përkatësisht, dënim të kushtëzuar, i cili do të jetë adekuat me peshën e veprës penale dhe me qëllimin e dënimit.

I akuzuari B. R, , në fund të procedurës deklaroi se e përkrahë fjalën e mbrojtësit të tij, për këtë është penduar shumë, l me të dëmtuarin tani janë pajtuar deh qëndrojnë mirë, andaj, lutë gjykatën që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari e ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188, par.2, lidhur me par.1, nën par.1.4 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, pajtimi me të dëmtuarin, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, mënyra e vrazhdë e kryerjes së kësaj vepre, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr. 463/17, më datë 23.06.2017**

**Zyrtarja ligjore,**  
Hikmete Velu-Pajaziti

**Gjykatësja e vetme gjyqësore,**  
Luljete Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.